

## Formular për SYLLABUS të Lëndës

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	Fakulteti Ekonomik
<b>Titulli i lëndës:</b>	Parimet e menaxhmentit
<b>Niveli:</b>	Bachelor
<b>Statusi lëndës:</b>	Zgjedhore
<b>Viti i studimeve:</b>	Viti I, Semestri I
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2+1
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	4
<b>Koha / lokacioni:</b>	Përcaktohet nga Dekanati
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	Prof. Ass. Dr. Liridon Veliu Prof. Asoc. Dr. Ymer Havolli
<b>Detajet kontaktuese:</b>	liridon.veliu@uni-pr.edu ymer.havolli@uni-pr.edu
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
	Ky kurs përfshin të gjitha elementet që ndikojnë në përvetësimin e njohurive në lidhje me parimet e menaxhmentit duke e përfshirë arritjen e aftësive dhe njohurive përkitazi me menaxhimin. Problemet e trajtuara në fushën e menaxhmentit të evoluimit të mendimit shkencorë, menaxhmenti në shoqërinë pluraliste, parimet e menaxhmentit modern, menaxhmenti në rrafshin kulturor dhe etik, kuptimi dhe efekti i menaxhmentit, planifikimit, organizimit, vendimmarrjes, udhëheqjes dhe kontrollit.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	
	Qëllimi i kursit është të sigurojë një kuptim të koncepteve bazë, parimeve dhe praktikave të menaxhimit. Qëllimi është të zhvilloj aftësinë për të aplikuar një qasje shumë funksionale ndaj arritjes së objektivave të organizatës. Përfitimi i njohurive teorike dhe praktike në fushën e parimeve të menaxhmentit. Përfshin të gjitha elementet që ndikojnë në fitimin e njohurive përkitazi me menaxhmentit, planifikimin, organizimin, udhëheqjen dhe kontrollin në kompani duke aplikuar metoda shkencore-hulumtuese.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	
	Pas përfundimit të ligjërimit të kësaj lënde studenti do të jetë në gjendje: - Të aftësojë studentët për njohuritë themelore lidhur me parimet e menaxhimit; - Të trajtojë problemet e parimeve të menaxhmentit në kompani,

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të menaxhoj zhvillimin e biznesit drejt majave më të larta të suksesit duke i përdorur parimet dhe konceptet e menaxhmentit modern</li> <li>- Të njohin motivimin dhe format e motivimit të të punësuarve</li> <li>- Të dallojnë skemat më funksionale organizative</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	13	26
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	20 min.	15	5
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	1	10	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	3	2	6
Projektet, prezentimet ,etj	1	4	4
<b>Totali</b>			<b>100</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<p>Mësimdhënia do të zhvillohet përmes ligjërates, detyrave praktike, interpretimeve individuale e grupore, punimit të seminareve, vetëvlerësimeve periodike.</p> <p>Metoda e punës gjatë orëve ligjërata do të përqendrohet në ligjërata dhe diskutime interaktive me pjesëmarrje të studentëve në procesin e mësimin, me prezantime individuale e grupore, të punimeve të ndryshme të përgatitura nga studentët.</p> <p>Studentët inkurajohen që paraprakisht të hulumtojnë dhe lexojnë materiale rreth temave vijuese, në mënyrë që të jenë më të përgatitur në orë të mësimin për të zhvilluar diskutime interaktive në mes të tyre me qëllim të përvetësimit më të shpejtë dhe më të thellë të çështjeve të rëndësishme të lëndës.</p>		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p>Vlerësimi i dijeve dhe aftësive të fituara bëhet përmes:</p>		

	<p>a) vijueshmërisë në ligjërata dhe ushtrime: 10 pikë</p> <p>b) aktivitetit dhe punimi seminarik: 10 pikë</p> <p>c) testi i parë: 40 pikë</p> <p>d) testi i dytë: 40 pikë</p> <p>Gjithsej: 100 pikë</p> <p>Vlerësimi i provimit përfundimtar, që vlerësohet me 51% të suksesit, me një sistem të ndërtimit të mëtejshëm të notës përfundimtare me kriteret tjera të lartë theksuara.</p>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<p>- Isa TAHIRI, “Parimet e Menaxhmentit”, Libër universitar, 2020, Prishtinë</p> <p>- Berim RAMOSAJ “Management /Bazat e menaxhimit”, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2013</p>
<b>Literatura shtesë:</b>	<p>- David S Bright, Anastasia H Cortes, Eva Hartmann, ” Principles of Management”, ISBN-10: 1680922890, ISBN-13: 978-1680922899, 12th Media Services, 2019</p> <p>- Talya Bauer, Berrin Erdogan, Jeremy Short, “Principles of Management”, FlatWorld, 2018</p>

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Prezantimi i syllabusit / Evoluimi i mendimit shkencor për parimet e menaxhmentit
<b>Java e dytë:</b>	Parimet e menaxhmentit në shoqërinë pluraliste
<b>Java e tretë:</b>	Menaxhmenti modern
<b>Java e katërt:</b>	Menaxhmenti në rrafshin kulturor dhe etik
<b>Java e pestë:</b>	Kuptimi dhe efekti i menaxhimit
<b>Java e gjashtë:</b>	Menaxhmimi i ekipeve dhe grupeve
<b>Java e shtatë:</b>	Testi i parë
<b>Java e tetë:</b>	Planifikimi dhe Strategjia
<b>Java e nëntë:</b>	Vendimmarrja menaxheriale
<b>Java e dhjetë:</b>	Menaxhimi i strukturës organizative
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Personeli dhe burimet njerëzore
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Teoritë menaxheriale të lidhshme dhe motivimit
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Negocimi për rezultatet e biznesit
<b>Java e katërmëdhjetë:</b>	Menaxhimi i konfliktit dhe diversitetit
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Testi i dytë

**Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Studentët inkurajohen që gjithmonë të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shtesë dhe konsultime të studentëve. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërata të lexojnë së paku literaturën që ju është caktuar dhe të kryejnë detyrat dhe esetë që do t'u jepen. Studentët nuk janë të obliguar tu nënshtrohen vlerësimeve gjatë semestrit.

Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat studimore. Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në ligjërata.

Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e ID kartelës në teste dhe provim. Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet t'i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.